



**RAPORTI VJETOR
MBI NGARKESËN E PUNËS
SË PROKURORIVE**

2022

Mars 2023

Ky raport është hartuar në përputhje me nenin 19 pika 1, të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit, Prokurori i Përgjithshëm publikon, brenda muajit mars të çdo viti, raportin vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive për vitin kalendarik paraardhës, si dhe rekomandimet për përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së tyre.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” kanë sanksionuar se prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

Prokuroria përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- c) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Në vitin 2022, numri i përgjithshëm i miratuar është **321** prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Shpërndarja e tyre në prokuroritë sipas niveleve ka qenë: 278 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 26 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 17 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme. Ndërkohë, për shkak të vakancave numri faktik i prokurorëve ka qenë 174 në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 16 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 12 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, që krahasuar me vitin 2021¹ përbëjnë ulje përkatësisht prej 1,46 % të numrit faktik total të prokurorëve.

Në vitin 2022 numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës për secilin nivel prokurorie paraqitet:

¹ Numri faktik i prokurorëve në vitin 2021 ka qenë 205, përkatësisht 177 në prokuroritë e shkallës parë, 16 në prokuroritë e apeleve dhe 12 në Prokurorinë e Përgjithshme.

1. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm:

Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë	Prokurorë			Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë ²	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	80	45	43.75	53	52	71	69	204	166
Berat	7	6	5.50	9	9	8	8	24	23
Dibër	6	5	4.25	6	5	7	7	19	17
Durrës	27	19	17.75	15	15	23	21	65	55
Elbasan	25	16	15.50	14	14	20	19	59	49
Gjirokastrë	7	6	5	7	7	11	11	25	24
Fier	14	10	12	15	15	17	17	46	42
Korçë	13	11	8	13	10	19	19	45	40
Krujë	7	5	5	5	5	5	5	17	15
Kukës	5	3	2	5	5	7	7	17	15
Lushnjë	7	4	3.5	6	6	9	9	22	19
Lezhë	10	7	6.50	7	7	11	11	28	25
Mat	3	2	2	2	2	4	3	9	7
Përmet	2	1	1	1	1	4	3	7	5
Pukë	2	1	1	1	1	4	4	7	6
Pogradec	4	3	2.50	4	4	6	6	14	13
Sarandë	7	5	4.50	7	6	6	6	20	17

² Llogaritja e numrit efektiv është bërë sipas kohës reale të punës së prokurorit në prokurorinë përkatëse, ku:

Me pak se një muaj (30 dite) = 0 prokuror

Nga 1 në 3 muaj = 0,25 prokuror

Nga 4 në 6 muaj = 0,5 prokuror

Nga 7 në 9 muaj = 0,75/prokuror

Nga 10 në 12 muaj = 1 prokuror

Shkodër	19	11	9	15	15	21	21	55	47
Tropojë	3	2	1.50	2	1	4	4	9	7
Vlorë	19	13	12	17	17	17	17	53	47
Kavajë	7	3	3	3	3	6	6	16	12
Kurbin	4	3	2.50	4	3	6	6	14	12

2. Në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

Prokuroritë pranë gjykatave të apelit	Prokurorë			Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
Tiranë	9	6	5.75	10	10	19	16
Durrës	4	3	3	4	4	8	7
Gjirokastrë	2	1	1	2	2	4	3
Vlorë	5	2	2	4	4	9	6
Shkodër	4	2	2	3	3	7	5
Korçë	2	2	2	2	2	4	4

3. Në Prokurorinë e Përgjithshme:

Prokuroria e Përgjithshme	Prokurorë			Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
	17	12	11	35	31	84	71	136	114


Duke iu referuar të dhënave statistikore vjetore të përcjella nga prokuroritë, volumi i punës dhe ngarkesa mesatare analizohet në vijim:

I. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

I.1 Volumi në hetim

Volumi i punës në hetim në shkallë vendi

Gjatë vitit 2022, në organin e prokurorisë janë trajtuar 61045³ materiale kallëzuese që përbën një rritje prej 0,11% në krahasim me vitin 2021. Janë ndjekur gjithsej 48250 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej 1,63 % në krahasim me vitin 2021, nga të cilat 25708 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 9,32 % në krahasim me vitin 2021 dhe 677 procedime penale të rifilluara, që tregon ulje prej 27,52 % në krahasim me vitin 2021. Janë mbartur, 21865 procedime penale me një rritje prej 20,19 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2021. Është vendosur mosfillimi për 12795 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 5,23% në krahasim me vitin 2021.




Volumi në hetim ku përfshihen çështjet e mbartura, çështjet e regjistruara, çështjet e rifilluara dhe ato të mosfilluara, për vitin 2022 sipas prokurorive është si më poshtë:

³ Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2022 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2021; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2022 pa përfshirë procedimet e regjistruara sipas kodit penal ushtarak.

Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë ndjekur 2802 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë ndjekur 1777 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë ndjekur 6047 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë ndjekur 3765 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë ndjekur 3004 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastër janë ndjekur 1714 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë ndjekur 1144 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë ndjekur 2876 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë ndjekur 1482 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë ndjekur 864 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë ndjekur 714 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë ndjekur 1910 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje janë ndjekur 1881 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë ndjekur 347 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë ndjekur 278 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë ndjekur 1082 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë ndjekur 174 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë ndjekur 2199 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë ndjekur 3911 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë janë ndjekur 18638 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë ndjekur 524 çështje;
Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë ndjekur 3912 çështje.


Grafikisht këto të dhëna paraqiten si vijon:



Volumi në hetim 2022



Në vitin 2022 raporti i numrit të çështjeve në hetim me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve, sipas prokurorive paraqitet në grafikët në vijim:

Ngarkesa mestare në hetim për çdo prokuror sipas numrit organik






1.2 Sipas prokurorive të shkallës së parë, numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2022 është si vijon:


Në prokurorinë e shkallës së parë Berat janë regjistruar 680 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Dibër janë regjistruar 516 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Durrës janë regjistruar 2288 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Elbasan janë regjistruar 1770 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Fier janë regjistruar 1483 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Gjirokastrë janë regjistruar 599 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Kavajë janë regjistruar 542 procedime penale;
 Në prokurorinë e shkallës së parë Korçë janë regjistruar 1219 procedime penale;

Në prokurorinë e shkallës së parë Krujë janë regjistruar 496 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Kukës janë regjistruar 504 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Kurbin janë regjistruar 353 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Lezhë janë regjistruar 965 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Lushnje janë regjistruar 778 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Mat janë regjistruar 178 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Përmet janë regjistruar 167 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Pogradec janë regjistruar 452 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Pukë janë regjistruar 59 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Sarandë janë regjistruar 354 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Shkodër janë regjistruar 1767 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Tiranë janë regjistruar 8709 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Tropojë janë regjistruar 218 procedime penale;
Në prokurorinë e shkallës së parë Vlorë janë regjistruar 1611 procedime penale.

Grafikët më poshtë paraqesin të dhënat mbi procedimet penale të regjistruara dhe numrin e të pandehurve/personave nën hetim të regjistruar sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2022:




Të pandehur të regjistruar




Raporti i numrit mesatar të çështjeve të regjistruara sipas numrit organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve sipas prokurorive paraqitet në vijim:


Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit organik





Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit faktik





Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit efektiv



I.3 Në analizë të përqindjes që zënë procedimet e regjistruara dhe procedimet e mbartura në volumin e punës sipas prokurorive, të dhënat rezultojnë si më poshtë:



I.4 Në analizë të përqindjes që zënë raporti i procedimeve të përfunduara me çështjet e regjistruara dhe procedimeve të përfunduara me procedimet në ndjekje sipas prokurorive, të dhënat rezultojnë si më poshtë:



II. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës ka shqyrtuar 312 çështje themeli dhe 346 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë ka shqyrtuar 88 çështje themeli dhe 184 çështje lidhur me masat e sigurimit;


Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë ka shqyrtuar 108 çështje themeli dhe 203 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër ka shqyrtuar 285 çështje themeli dhe 320 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë ka shqyrtuar 880 çështje themeli dhe 1092 çështje lidhur me masat e sigurimit;

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ka shqyrtuar 262 çështje themeli dhe 451 çështje lidhur me masat e sigurimit.

Grafikisht të dhënat paraqiten si vijon, ku siç vërehet Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë edhe për vitin 2022 ka patur ngarkesën më të madhe:




Raporti i numrit mesatar të çështjeve me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve sipas prokurorisë përkatëse paraqitet në vijim:


Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit organik



Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit faktik



Ngarkesa mesatare për çdo prokuror sipas numrit efektiv



III. Ngarkesa e punës së Prokurorisë së Përgjithshme

III.1 Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar organin e akuzës pranë Gjykatës së Lartë në 75 çështje, prej të cilave 65 gjykime themeli (nga 34 gjykime themeli në vitin 2021), 4 përfaqësime në gjykime për të njëzuar/ndryshuar praktikën gjyqësore, dhe 6 gjykime për masa sigurimi (20 gjykime për masa sigurimi në vitin 2021), si dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 11 çështje (nga 5 çështje në vitin 2021).

III.2 Mosmarrëveshje për kompetencë

Gjatë vitit 2022 janë marrë 40 vendime për zgjidhje të mosmarrëveshjeve për kompetencën tokësore apo lëndore në hetimit paraprak të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

III.3 Akte nënligjore

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022 në përmbushje të **objektivave prioritare të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022 dhe në kuadrin e rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe ndërkombëtare** janë përgatitur dhe miratuar nga Prokurori Përgjithshëm:

3.1 Udhëzime të Përgjithshme:

- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr. 02, datë 29.07.2022 “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022 në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr. 01, datë 25.02.2022 “Për administrimin, qarkullimin dhe ruajtjen e vendimeve të përgjimit parandalues të klasifikuara “Sekret shtetëror””;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr. 03, datë 06.09.2022 “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”;
- ✓ Udhëzim i Përgjithshëm nr. 04, datë 18.10.2022 “Për disa shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr. 10, datë 30.12.2021 “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”.

3.2 Akte të tjera normative:

- Urdhër nr. 40, datë 20.06.2022 “Për miratimin e një shtese në “Rregulloren standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”;
- Urdhër nr. 56, datë 29.07.2022 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 14.07.2022 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2021”;
- Urdhër nr. 57, datë 29.07.2022 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022””;
- Urdhër nr. 61, datë 06.09.2022 “Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”.

3.3 Akte të përbashkëta:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 1547 prot., datë 15 nëntor 2022, ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Kulturës Rinisë

dhe Sportit “Për ruajtjen e përkohshme të objekteve të sekuestruara pjesë e trashëgimisë kulturore”;

- Marrëveshja e Punës ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Zyrës së Prokurorit Publik Evropian (“ZPPE”) “Për bashkëpunimin ndërmjet Zyrës së Prokurorit Publik Evropian (ZPPE) dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë”, nënshkruar me datë 04 korrik 2022;
- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë (PP) dhe Shoqatës Ibero-Amerikane të Ministrive Publike (AIAMP), nënshkruar me datë 29 korrik 2022.

III.4 Dekriminalizimi

Në Sektorin e Dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për vitin 2022 janë regjistruar 111 kërkesa për verifikim të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklaruar të personave, subjekt i këtij ligji. Për 76 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 35 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr. 138/2015 dhe vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me vendimarrjen e vitit 2022, për 54 raste, Prokuroria e Përgjithshme ka vendosur mospranimin e tyre, për arsye të mosplotësimit të kushteve e kritereve për verifikim të thelluar, të përcaktuara në ligj.

III.5 Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2022, ka trajtuar:

- Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit, në total 119 praktika dhe janë përfunduar gjithsej 49 praktika;
- Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë, në total 161 praktika, të përfunduara 62;


- Urdhër arreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, në total 252 praktika;
- Letërporosi nga Jashtë, në total 489 praktika, 284 të përfunduara;
- Letërporosi për jashtë, 526 praktika, 173 të përfunduara;
- Shpallje e shtetasve shqiptarë ose të huaj në kërkim ndërkombëtar, 245 praktika;
- Heqje e shtetasve shqiptarë nga kërkimi ndërkombëtar 134 praktika;
- Transferime të dënuarish nga jashtë, 10 praktika;
- Transferim procedimi nga jashtë drejt Shqipërisë, 17 praktika;
- Transferim procedimi nga Shqipëria për jashtë, 11 praktika;
- Njohjet e vendimeve penale të ardhura nga jashtë, 19 praktika në total;
- Njohjet e vendimeve penale shqiptare të dërguara jashtë vendit, 7 praktika;
- Praktika të tjera 570 në total, ku përfshihen dhënie mendimi për akte nënligjore të ndryshme, kontributet për raportime, kërkesa për informacion nga subjekte etj.

III.6 Përgjimet

Gjatë vitit 2022 është përdorur përgjimi i komunikimeve elektronike nga prokurorët në fazën e hetimeve paraprake si mjet për sigurimin e provës në 573 procedime penale. Është realizuar përgjimi për 3391 pajisje fundore në përdorim të 3089 subjekteve ndaj të cilëve ishte lejuar përgjimi. Në total janë ekzekutuar 1312 vendime për përgjim të autorizuar nga gjykata dhe 607 urdhra/autorizime të prokurorit.

IV. Ngarkesa në pesë vitet e fundit

Volumi në hetim në shkallë vendi në pesë vitet e fundit, me tregues ngarkesa totale në hetime (materjale kallëzuese/referime të trajtuara), ku përfshihen procedime penale të regjistruara, procedime të mbartura nga viti paraardhës, mosfillime procedimi për kallëzime/referime dhe rifillime procedimi të pezulluara ose të pushuara, paraqitet grafikisht në vijim:



Volumi në hetim sipas prokurorive në pesë vitet e fundit, **numri organik** i prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e shkallës së parë	Ngarkesa	2018	2019	2020	2021	2022
	Volumi në hetim	1898	2212	2176	2664	2802
<i>Berat</i>	Numri i prokurorëve	6	6	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	316	369	311	381	400
	Volumi në hetim	987	943	1178	1568	1777
<i>Dibër</i>	Numri i prokurorëve	6	6	6	6	6
	Mesatarja për prokuror	165	157	196	261	296
	Volumi në hetim	5152	5812	5631	5996	6047
<i>Durrës</i>	Numri i prokurorëve	26	26	27	27	27
	Mesatarja për prokuror	198	224	209	222	224
	Volumi në hetim	3788	4294	4341	3740	3765
<i>Elbasan</i>	Numri i prokurorëve	25	25	25	25	25

	Mesatarja për prokuror	152	172	174	150	151
	Volumi në hetim	2871	2864	2705	2958	3004
<i>Fier</i>	Numri i prokurorëve	14	14	14	14	14
	Mesatarja për prokuror	205	205	193	211	215
	Volumi në hetim	1483	1786	1955	1861	1714
<i>Gjirokastrë</i>	Numri i prokurorëve	5	5	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	297	357	279	266	245
	Volumi në hetim	1047	1101	1050	1144	1144
<i>Kavajë</i>	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	150	157	150	163	163
	Volumi në hetim	2791	2864	2740	2951	2876
<i>Korçë</i>	Numri i prokurorëve	13	13	13	13	13
	Mesatarja për prokuror	215	220	211	227	221
	Volumi në hetim	1172	1335	1777	1539	1482
<i>Krujë</i>	Numri i prokurorëve	6	6	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	195	223	254	220	212
	Volumi në hetim	699	666	808	956	864
<i>Kukës</i>	Numri i prokurorëve	4	4	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	175	167	162	191	173
	Volumi në hetim	899	898	811	966	714
<i>Kurbin</i>	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	225	225	203	242	179
	Volumi në hetim	2127	1723	1686	1934	1910
<i>Lezhë</i>	Numri i prokurorëve	10	10	10	10	10
	Mesatarja për prokuror	213	172	169	193	191
	Volumi në hetim	1617	1791	1620	1757	1881
<i>Lushnje</i>	Numri i prokurorëve	7	7	7	7	7

	Mesatarja për prokuror	231	256	231	251	269
	Volumi në hetim	360	340	287	286	347
<i>Mat</i>	Numri i prokurorëve	3	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	120	113	96	95	116
	Volumi në hetim	214	224	301	231	278
<i>Përmet</i>	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	107	112	151	116	139
	Volumi në hetim	1034	1012	937	970	1082
<i>Pogradec</i>	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	259	253	234	243	271
	Volumi në hetim	230	299	178	265	174
<i>Pukë</i>	Numri i prokurorëve	3	3	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	77	100	89	133	87
	Volumi në hetim	1849	2276	2241	2114	2199
<i>Sarandë</i>	Numri i prokurorëve	5	5	7	7	7
	Mesatarja për prokuror	370	455	320	302	314
	Volumi në hetim	3357	3004	3611	3541	3911
<i>Shkodër</i>	Numri i prokurorëve	19	19	19	19	19
	Mesatarja për prokuror	177	158	190	186	206
	Volumi në hetim	18924	19168	17824	18290	18638
<i>Tiranë</i>	Numri i prokurorëve	77	77	80	80	80
	Mesatarja për prokuror	246	249	223	229	233
	Volumi në hetim	447	390	438	523	524
<i>Tropojë</i>	Numri i prokurorëve	3	3	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	149	130	146	174	175
	Volumi në hetim	4121	4091	4171	4722	3912
<i>Vlorë</i>	Numri i prokurorëve	20	20	19	19	19

Mesatarja për prokuror	206	205	220	249	206
------------------------	-----	-----	-----	-----	-----

Volumi në prokuroritë pranë gjykatave të apelit në pesë vitet e fundit, **numri organik** i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e Apelit	Ngarkesa	2018	2019	2020	2021	2022
	Volumi	761	761	596	696	658
<i>Durrës</i>	Numri i prokurorëve	5	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	152	190	149	174	165
	Volumi	238	193	211	265	272
<i>Gjirokastrë</i>	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	119	97	106	133	136
	Volumi	405	274	360	338	311
<i>Korçë</i>	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	203	137	180	169	156
	Volumi	1279	670	470	648	605
<i>Shkodër</i>	Numri i prokurorëve	4	4	4	4	4
	Mesatarja për prokuror	320	168	118	162	151
	Volumi	3113	2085	1288	1498	1972
<i>Tiranë</i>	Numri i prokurorëve	9	9	9	9	9
	Mesatarja për prokuror	346	232	143	166	219
	Volumi	1001	281	666	820	713
<i>Vlorë</i>	Numri i prokurorëve	5	5	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	200	56	133	164	143

Volumi në hetim sipas prokurorive në pesë vitet e fundit, **numri faktik** i prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e shkallës së parë	Ngarkesa	2018	2019	2020	2021	2022
<i>Berat</i>	Volumi në hetim	1898	2212	2176	2664	2802
	Numri i prokurorëve	6	5	7	3	6
	Mesatarja për prokuror	316	442	311	888	467
<i>Dibër</i>	Volumi në hetim	987	943	1178	1568	1777
	Numri i prokurorëve	6	6	4	4	5
	Mesatarja për prokuror	165	157	295	392	355
<i>Durrës</i>	Volumi në hetim	5152	5812	5631	5996	6047
	Numri i prokurorëve	25	26	23	21	19
	Mesatarja për prokuror	206	224	245	286	318
<i>Elbasan</i>	Volumi në hetim	3788	4294	4341	3740	3765
	Numri i prokurorëve	25	25	20	17	16
	Mesatarja për prokuror	152	172	217	220	235
<i>Fier</i>	Volumi në hetim	2871	2864	2705	2958	3004
	Numri i prokurorëve	14	14	13	12	10
	Mesatarja për prokuror	205	205	208	247	300
<i>Gjirokastrë</i>	Volumi në hetim	1483	1786	1955	1861	1714
	Numri i prokurorëve	5	5	4	4	6
	Mesatarja për prokuror	297	357	489	465	286
<i>Kavajë</i>	Volumi në hetim	1047	1101	1050	1144	1144
	Numri i prokurorëve	6	6	6	3	3
	Mesatarja për prokuror	175	184	175	381	381
<i>Korçë</i>	Volumi në hetim	2791	2864	2740	2951	2876
	Numri i prokurorëve	11	11	10	7	11
	Mesatarja për prokuror	254	260	274	422	261
<i>Krujë</i>	Volumi në hetim	1172	1335	1777	1539	1482

	Numri i prokurorëve	5	4	5	5	5
	Mesatarja për prokuror	234	334	355	308	296
<i>Kukës</i>	Volumi në hetim	699	666	808	956	864
	Numri i prokurorëve	3	4	4	2	3
	Mesatarja për prokuror	233	167	202	478	288
<i>Kurbin</i>	Volumi në hetim	899	898	811	966	714
	Numri i prokurorëve	4	4	3	2	3
	Mesatarja për prokuror	225	225	270	483	238
<i>Lezhë</i>	Volumi në hetim	2127	1723	1686	1934	1910
	Numri i prokurorëve	10	9	8	5	7
	Mesatarja për prokuror	213	191	211	387	273
<i>Lushnje</i>	Volumi në hetim	1617	1791	1620	1757	1881
	Numri i prokurorëve	7	7	6	3	4
	Mesatarja për prokuror	231	256	270	586	470
<i>Mat</i>	Volumi në hetim	360	340	287	286	347
	Numri i prokurorëve	3	3	1	2	2
	Mesatarja për prokuror	120	113	287	143	174
<i>Përmet</i>	Volumi në hetim	214	224	301	231	278
	Numri i prokurorëve	2	2	2	1	1
	Mesatarja për prokuror	107	112	151	231	278
<i>Pogradec</i>	Volumi në hetim	1034	1012	937	970	1082
	Numri i prokurorëve	4	4	3	3	3
	Mesatarja për prokuror	259	253	312	323	361
<i>Pukë</i>	Volumi në hetim	230	299	178	265	174
	Numri i prokurorëve	2	3	2	2	1
	Mesatarja për prokuror	115	100	89	133	174
<i>Sarandë</i>	Volumi në hetim	1849	2276	2241	2114	2199

	Numri i prokurorëve	5	5	6	4	5
	Mesatarja për prokuror	370	455	374	529	440
<i>Shkodër</i>	Volumi në hetim	3357	3004	3611	3541	3911
	Numri i prokurorëve	19	18	15	11	11
	Mesatarja për prokuror	177	167	241	322	356
<i>Tiranë</i>	Volumi në hetim	18924	19168	17824	18290	18638
	Numri i prokurorëve	76	77	62	52	45
	Mesatarja për prokuror	249	249	287	352	414
<i>Tropojë</i>	Volumi në hetim	447	390	438	523	524
	Numri i prokurorëve	3	3	3	1	2
	Mesatarja për prokuror	149	130	146	523	262
<i>Vlorë</i>	Volumi në hetim	4121	4091	4171	4722	3912
	Numri i prokurorëve	18	18	16	13	13
	Mesatarja për prokuror	229	227	261	363	301

Volumi në prokuroritë pranë gjykatave të apelit në pesë vitet e fundit, **numri faktik** i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror rezulton si vijon:

Prokuroria e Apelit	Ngarkesa	2018	2019	2020	2021	2022
	Volumi	761	761	596	696	658
<i>Durrës</i>	Numri i prokurorëve	5	3	3	4	3
	Mesatarja për prokuror	152	254	199	174	219
	Volumi	238	193	211	265	272
<i>Gjirokastrë</i>	Numri i prokurorëve	2	2	1	1	1
	Mesatarja për prokuror	119	97	211	265	272
	Volumi	405	274	360	338	311
<i>Korçë</i>	Numri i prokurorëve	2	2	2	2	2

	Mesatarja për prokuror	203	137	180	169	156
	Volumi	1279	670	470	648	605
<i>Shkodër</i>	Numri i prokurorëve	4	2	2	2	2
	Mesatarja për prokuror	320	335	235	324	303
	Volumi	3113	2085	1288	1498	1972
<i>Tiranë</i>	Numri i prokurorëve	9	7	6	5	6
	Mesatarja për prokuror	346	298	215	300	329
	Volumi	1001	281	666	820	713
<i>Vlorë</i>	Numri i prokurorëve	5	4	4	2	2
	Mesatarja për prokuror	200	70	167	410	357

V. Rekomandime

Në vitin 2023, me qëllim përmirësimin e strukturave dhe kapaciteteve institucionale e profesionale si dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së prokurorisë, rekomandohet:

1. Vijimi i punës për forcimin e kapaciteteve institucionale për rritjen e efikasitetit në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe i kapaciteteve profesionale për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve:

1.1 Në kuadrin e zbatimit të hartës së re gjyqësore të vijoje puna e nisur në bashkërendim dhe koordinim me KLGJ dhe MD për rritjen e kapaciteteve akomoduese me ambiente pune për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, administratën dhe shërbimet mbështetëse në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, dhe përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore për përmirësimin e infrastrukturës në prokurori, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe për sigurimin e aksesit të shtetasve në prokurori.

1.2 Vijimi i bashkërendimit dhe koordinimit me KLP dhe Shkollën e Magjistraturës, për të planifikuar më në kohë zëvendësimin e prokurorëve të shkarkuar nga detyra me magjistrat/prokuror sipas ligjit, me synim për të shmangur rritjen progresive të numrit

organik të prokurorëve që i mungojnë sistemit të prokurorisë në të tre nivelet pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm

2. Të vijojë rritja më tej e veprimtarisë monitoruese për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme⁴ dhe e bashkëpunimit me ILD dhe KLP në drejtim të koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informacionit, identifikimit të shkeljeve disiplinore apo etike dhe problemeve të performancës së zyrave të prokurorive, nëpërmjet aktiviteteve:

2.1 Struktura përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme në bashkërendim me drejtuesit e prokurorive të vijnë qasjen proaktive, me prioritet mbledhjen dhe analizën e informacionit të përftuar për problematikat e evidentuara, në funksion të rritjes së bashkëpunimit, koordinimit dhe monitorimit institucional dhe ndërinstitucional, si dhe garantimin e zbatimit të parimit të funksionalitetit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm;

2.3 Rritja më tej e efikasitetit të bashkëpunimit, koordinimit dhe monitorimit të veprimtarisë së strukturave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme me drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme apo akteve të tjera normative, planeve të veprimit dhe/ose strategjive institucionale apo ndërinstitucionale, të fokusura për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe/ose rekomandimeve ndërkombëtare në kuadrin e integritetit evropian të vendit, sipas ligjit.

2.4 Vijimi i punës së nisur përgjatë vitit 2022 për përmirësimin e sistemit elektronik (SVHOPGJP) dhe vënien e tij në funksionim të plotë për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe për monitorimin periodik të ngarkesës dhe disiplinës në punë gjatë veprimtarisë së tyre në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2021 “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”, i ndryshuar, me synim administrimin e punës të secilit oficer të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe për të vijuar lehtësimin dhe mbështetjen e prokurorëve me numër të reduktuar në prokuroritë përkatëse.

⁴ Shih, pikën 2 të nenit 6 dhe pikën 1 të nenit 46 në lidhje me nenin 2 shkronja “c” të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh”, ku parashikohet se, udhëzimet e përgjithshme dhe të arsyetuara me shkrim të prokurorëve më të lartë janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët.

3. Të vijojë puna për të shmangur efektet negative të vakancave nga ulja e numrit të prokurorëve në kuadrin e procesit të rivlerësimit kalimtar, nëpërmjet rishikimit të strukturave organike dhe faktike në kuadrin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë përkatëse që kanë rritje të numrit të procedimeve mbi nivelin mesatar të ngarkesës efektive për prokuror dhe t'i kërkohej KLP kryerja e transferimeve të përkohshme të nevojshme për të normalizuar veprimtarinë në ato prokurori.

4. Të vijojë puna e nisur në bashkëpunim me KLGJ për të ndjekur ecurinë e masave konkrete dhe për të mundësuar dixhitalizimin në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, me prioritetet:

4.1 Të vijojë bashkërendimi dhe koordinimi i strukturave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë KLGJ për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori me standardet aktuale⁵.

4.2 Të vijojë me tej puna e nisur dhe e pa përfunduar nga Projekti Euralius V për zhvillimin dhe përfundimin e sistemit elektronik PRESTO, për administrimin elektronik të regjistrave procedural dhe përfitimin e statistikave me të dhëna në kohë reale dhe gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të besueshme në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në këtë periudhë të ndërmjetme/tranzitore, deri në ngritjen dhe funksionimin e sistemit të ri CAMS.

5. Të vijojë rritja më tej e efikasitetit të bashkërendimit ndërinstitucional dhe koordinimit me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe me agjencitë ligjzbatuese të përfshira, për forcimin e kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore në strukturat përkatëse të seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore, me synim rritjen më tej të cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e hetimeve në drejtimet prioritare të luftës kundër kriminalitetit në zbatim të Kodit të Procedurës Penale, Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit dhe ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar.

⁵ Shih, masa/aktivitetit 4.1.7 në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë për vitet 2022-2025, miratuar me 24.12.2021.